

[Handwritten signature]

STATUTI I

SHOQËRISË AKSIONARE

MOGO ALBANIA SH.A.



[Handwritten signature]

INDEKSI

TITULLI I.....	5
Themelimi, Emri, Qëllimi, Kohëzgjatja, Selia dhe Website	5
NENI 1.....	5
Themelimi.....	5
NENI 2.....	5
Objekti i Shoqërisë	5
NENI 3.....	5
Kohëzgjatja.....	5
NENI 4.....	5
Selia, Website dhe adresa elektronike, Pronësia Intelektuale	5
TITULLI II	5
Kapitali i Regjistruar, Kontributet, Aksionet, Aksionarët.....	5
NENI 5.....	5
Kapitali i Regjistruar, Kontributet	5
NENI 6.....	6
Aksionet, Aksionarët	6
TITULLI III.....	6
Veprime me Kapitalin, me Aksionet, Regjistri i Aksioneve	6
NENI 7.....	6
Zmadhimi i Kapitalit	6
NENI 8.....	6
Njoftimi i Zmadhimit, Regjistrimi i Realizimit të Zmadhimit të Kapitalit	6
NENI 9.....	6
Akti i Emetimit të Aksioneve	6
NENI 10.....	7
Zvogëlimi i Kapitalit	7
NENI 11.....	7
Kalimi i Aksioneve.....	7
NENI 12.....	8
Regjistri i Aksioneve	8
TITULLI IV.....	9
Asambleja e Përgjithshme	9
NENI 13.....	9
Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme	9
NENI 14.....	9
Punimet e Mbledhjes së Asamblesë së Aksionarëve.....	9
NENI 15.....	10
Votat e Aksionarëve	10
NENI 16.....	10
Përfaqësimi në Asamble	10
TITULLI V	11
Administrimi i Shoqërisë.....	11
NENI 17.....	11
Këshilli Mbikqyrës	11
Emërimi, Shkarkimi, Vendet e lira, Kompetencat, Shpërblimi.....	11
NENI 18.....	11
Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës.....	11
NENI 19.....	11

Drejtorët Ekzekutivë.....	11
Emërimi, Kompetencat, Shpërblimi	11
TITULLI VI.....	12
Dividendët dhe Rezervat	12
NENI 20.....	12
Dividendët	12
NENI 21.....	12
Rezervat	12
TITULLI VII	12
Neni 22	12
Rregulloret, Komitetet dhe Marrëveshjet midis Aksionarëve	12
TITULLI VIII.....	13
Prishja dhe Likuidimi	13
NENI 23.....	13
Prishja dhe Likuidimi	13
TITULLI XI.....	13



**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË AKSIONARE**

MOGO ALBANIA SH.A

Në këtë dokument, nëse nuk përcaktohet ndryshe, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- “Ligji Tregtar”:** Ligji nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- “Ligji për Bankat”:** Ligji nr. 9662 datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”. Ligji Nr.8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe Rregullores Nr.01, datë 17.01.2013 “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka” dhe cdo ndryshim në ligj;
- “Statuti”:** Ky statut i shoqërisë aksionare Mogo Albania Sh.a;
- “Shoqëria”:** Mogo Albania Sh.a., e themeluar si shoqëri aksionare (Sh.a.) sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe subjekt licencimi si subjekt financiar jo-banka nga Banka e Shqipërisë;
- “Aksionar(ët)”:** Sipas rastit, personat fizikë ose juridikë që zotërojnë aksionet e Shoqërisë në përputhje me kërkesat e nenit 5, 6 dhe 11 të këtij Statuti;
- “Vendim i Zakonshëm”:** Vendimi i miratuar nga Asambleja e Aksionarëve me shumicën e votave të Aksionarëve pjesëmarrës sipas kërkesave të nenit 145 (2) të Ligjit Tregtar;
- “Vendim i Jashtëzakonshëm”:** Vendimi i miratuar nga Asambleja e Aksionarëve me tre të katërtat e votave të Aksionarëve pjesëmarrës në votim sipas kërkesave të nenit 145 (1) të Ligjit Tregtar;
- “Pjesëmarrje Influencuese”:** është zotërimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i së drejtës së pronësisë mbi 10 për qind ose më shumë të kapitalit të personit juridik ose të aksioneve të tij me të drejtë vote, ose në një masë të tillë që krijon mundësi të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në drejtimin apo në politikën e këtij personi juridik;
- “Shoqëri mëmë”** është personi juridik, i cili, në marrëdhënie me një person tjetër juridik, plotëson të paktën një nga kushtet e mëposhtme:
- a) zotëron shumicën e të drejtave të votës në këtë person;
 - b) ka të drejtën të emërojë dhe të shkarkojë shumicën e anëtarëve të drejtorisë ose të këshillit mbikëqyrës/drejtuës ose të organeve të tjera drejtuese dhe/ose mbikëqyrëse të këtij personi dhe është, në të njëjtën kohë, anëtar ose aksionar i këtij personi;
 - c) ka të drejtën të ushtrojë një ndikimin dominues mbi këtë person, në sajë të një marrëveshjeje kontraktuale, të lidhur në bazë të legjislacionit tregtar ose për shkaqe të tjera ligjore;
 - ç) është anëtar ose aksionar i atij personi dhe ka shumicën e të drejtave të votës së tij, në sajë të një kontrate ose marrëveshjeje tjetër ligjore, të lidhur me anëtarët ose aksionarët e tjerë.
- “Shumicë”:** është në çdo rast shumica e thjeshtë 50 për qind të votave plus 1 votë.”.
- “Person”:** Çdo person fizik apo juridik;
- “Trashëgimtar”:** personi që sipas ligjit, është trashëgimtar universal i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të Aksionarit apo ka të drejta në lidhje me zotërimin dhe/ose përfitimin e çdo të drejte ligjore mbi pasuritë e Aksionarit si pasojë e vdekjes së tij, transformimit, prishjes së shoqërisë, falimentimit/likuidimit dhe çdo mjeti tjetër ligjor;
- “Website”:** Hapësira zyrtare e internetit të shoqërisë;
- “Kontroll”:** Një marrëdhënie juridike apo faktike ku një Person zotëron ose kontrollon, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë shumicën e aksioneve apo të votave të një shoqërie;
- “Shoqëri e Kontrolluar”:** Është shoqëria tregtare me zyrë qendrore në Republikën e Shqipërisë apo jashtë shtetit, e cila kontrollohet nga një a më shumë Aksionarë;



“Ligji për QKB-në”:	Ligji nr. 9723 datë 03.05.2007 “Mbi Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
“QKB”:	Qendra Kombëtare e Regjistrimit e themeluar sipas Ligjit për QKB-në e cila mban Regjistrin Tregtar Shqiptar;
“Ligji për Titujt”:	Ligji nr. 9879 datë 21.02.2008 “Për Titujt”.

TITULLI I

Themelimi, Emri, Qëllimi, Kohëzgjatja, Selia dhe Website

NENI 1

Themelimi

(1) Shoqëria është themeluar si shoqëri aksionare me ofertë private në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

NENI 2

Objekti i Shoqërisë

(1) Objekti i Shoqërisë do të jetë kryerja e aktiviteteve financiare jo-bankë, në Shqipëri dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin bankar të zbatueshëm dhe rregulloret e autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e aktivitetit financiar.

Më saktësisht, në përputhje me miratimet dhe licencat e dhëna nga autoritetet kompetente, Shoqëria mund të kryejë aktivitetet e Qirasë financiare, si p.sh shitjen dhe marrjen me qira në të njëjtën kohë; aktivitete për dhënie e kredive si p.sh për kredi konsumatore, kredi me titull sigurues makinë; faktoring; lëshimin e titujve; shitjen e makinave dhe makinerive të lehta, si psh shitjen me shumice dhe pakicë; dhënie me qira ditore ose mujore të makinerive motorike, kamionave, makinerive agro si dhe cdo aktivitet tjetër në lidhje me aktivitetin kreditues ose që është i nevojshëm për funksionimin e duhur të Shoqërisë.

(2) Shoqëria mund të themelojë, zotërojë pjesëmarrje a kontrollojë shoqëri të tjera tregtare, apo të bashkëpunojë, të lidhë marrëveshje *joint – venture* (bashkim i përkohshëm) a marrëveshje të ngjashme, me shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtë apo të ngjashëm me objektin e Shoqërisë.

NENI 3

Kohëzgjatja

(1) Shoqëria themelohet për të ushtruar aktivitetin e saj për një periudhe kohe të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

NENI 4

Selia, Website dhe adresa elektronike, Pronësia Intelektuale

(1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Nikolle Filja Nr 22 , Tirane, Shqiperi.

(2) Shoqëria mund të ketë *Website-in* e saj zyrtar dhe adresën e saj zyrtare për komunikimet elektronike të cilat mund të njoftohen vullnetarisht në QKB.

(3) Shenjat dalluese të aktivitetit ekonomik, të adresave elektronike dhe të Website-it mund të njoftohen vullnetarisht në QKB.

(5) Markat tregtare/patentat dhe pronësitë e tjera intelektuale të shoqërisë mund të regjistrohen në përputhje me legjislacionin mbi pronësinë intelektuale

TITULLI II

Kapitali i Regjistruar, Kontributet, Aksionet, Aksionarët

NENI 5

Kapitali i Regjistruar, Kontributet

(1) Kapitali i regjistruar i shoqërisë, është 20.000.000 (Njëzet milion) Lekë, i cili ndahet në 2.000.000 (dy milion) aksione të zakonshme, me vlerë nominale 10 (dhjetë) Lekë secila. Në momentin e nënshkrimit të këtij Statuti, Aksionet e Shoqërisë janë të nënshkruara dhe paguara në para nga Aksionari i vetëm Mogo Finance S.A. një shoqëri publike (shoqëri anonime), me adresë Rruga 6, Guillaume Schneider L-2522, Luxembourg Grand-Duchy te Luxembourg, i regjistruar në Regjistrin Tregtar te shoqërive në Luxembourg, me numër B 174.457.

NENI 6

Aksionet, Aksionarët

- (1) Aksionarët e Shoqërisë do të jenë subjektet të cilët kanë fituar pronësinë mbi aksionet e tyre në mënyrat e përcaktuara nga Ligji Tregtar dhe dispozitat e këtij Statuti.
- (2) Aksionet e Shoqërisë janë aksione të zakonshme, dhe një aksion përfaqëson një votë. Në rast se Votat do të kenë një kategori të ndryshme, sic mund të jenë Aksione me përparësi, me ose pa të drejtë vote, kjo do të vendoset nga Asambleja e Aksionarëve.

TITULLI III

Veprime me Kapitalin, me Aksionet, Regjistri i Aksioneve

NENI 7

Zmadhimi i Kapitalit

- (1) Asambleja e Aksionarëve, nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm, mund të zmadhojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar.
- (2) Secili Aksionar ekzistues, proporcionalisht me totalin e aksioneve të zotëruara, do të ketë të drejtën të nënshkruajë Aksionet që do të emetohen si pasojë e zmadhimit, duke u preferuar ndaj çdo Personi të tretë. Kjo e drejtë mund të kufizohet në bazë të një vendimi të Asamblesë së Aksionarëve sipas kërkesave të nenit 174(2) të Ligjit Tregtar.
- (3) Në rast emetimi aksionesh me prim, primi duhet të paguhet plotësisht përpara regjistrimit të realizimit të rritjes së kapitalit pranë QKB-së.
- (4) Nënshkrimi i aksioneve të reja duhet të kryhet brenda një afati prej 15 Ditësh Kalendarike nga data në të cilën Asambleja e Aksionarëve ka vendosur për rritjen e kapitalit. Aksionarët që nuk nënshkruajnë pjesën e tyre të aksioneve të reja brenda këtij afati do të konsiderohen se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes mbi aksionet e reja. Asambleja e Aksionarëve mund të vendosë afate të tjera në momentin e marrjes së vendimit për rritjen e kapitalit.
- (5) Të paktën $\frac{1}{4}$ e vlerës nominale të aksioneve të nënshkruara për kontributet në para duhet të paguhet menjëherë pas nënshkrimit dhe në çdo rast jo më vonë se 5 ditë nga nënshkrimi. Asambleja e Aksionarëve mund të vendosë për afate të ndryshme pagese në momentin e marrjes së vendimit për rritjen e kapitalit. Pjesa e mbetur e çmimit të aksioneve do të paguhet në një apo disa këste sipas përcaktimeve të Aktit të Emetimit të Aksioneve apo afateve të tjera të përcaktuara nga Asambleja e Aksionarëve në momentin e marrjes së vendimit për rritjen e kapitalit.
- (6) Kontributet në natyrë duhet të shlyhen plotësisht përpara regjistrimit të realizimit të rritjes së kapitalit pranë QKB-së. Vlerësimi i kontributeve në natyrë do të kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.
- (7) Shoqëria mund të zmadhojë kapitalin edhe sipas mënyrave, kushteve e procedurave të tjera të parashikuara nga Ligji Tregtar.
- (8) Në rastet kur emetimi i aksioneve të reja i nënshtrohet dispozitave të Ligjit për Titujt, shlyerja duhet të bëhet në përputhje edhe me afatet e përcaktuar nga Ligji për Titujt.
- (9) Shoqëria njofton pranë Bankës së Shqipërisë dhe QKB-së vendimin për zmadhimin e kapitalit sipas afateve e kërkesave të Ligjit për Bankat dhe Ligjit për QKB-në.

NENI 8

Njoftimi i Zmadhimit, Regjistrimi i Realizimit të Zmadhimit të Kapitalit

- (1) Vendimi Asamblesë së Aksionarëve për zmadhimin e kapitalit publikohet edhe në faqen e internetit të Shoqërisë, nëse ka, e në rastet kur kërkohet nga Ligji për Titujt, vendimi i njoftohet gjithashtu për miratim Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, së bashku me prospektin e përgatitur për këtë qëllim (për rastet kur hartimi i prospektit është i detyrueshëm).
- (2) Me përfundimin e nënshkrimit të aksioneve, Shoqëria regjistron në QKB Realizimin e Zmadhimit të Kapitalit, dhe depoziton listën e plotë të akteve në përputhje me ligjin e aplikueshëm
- (3) Regjistrimi i Realizimit të Zmadhimit të Kapitalit do t'i njoftohet Bankës së Shqipërisë në përputhje me ligjin për Bankat dhe rregulloret në fuqi.
- (4) Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të Realizimit të tij në QKB.

NENI 9

Akti i Emetimit të Aksioneve

- (1) Aksionet emetohen nëpërmjet Aktit të Emetimit të Aksioneve që miratohet pa vonesa nga Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë në lidhje me pjesën e realizuar të zmadhimit të kapitalit pasi zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv. Aksionet e reja nuk mund të emetohen, dhe aksionet e të drejtat e

lidhura me to nuk mund të transferohen përpara se zmadhimi i kapitalit të bëhet efektiv e të miratohet Akti i Emetimit të Aksioneve.

(2) Aktit të Emetimit të Aksioneve i bashkëngjitet lista e plotë e personave që kanë nënshkruar aksionet.

(3) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në vendimin e Asamblesë së Aksionarëve që miraton zmadhimin, aksionet e reja marrin pjesë në fitimet e të gjithë vitit financiar, në të cilin është marrë vendimi për rritjen e kapitalit. Vendimi mund të parashikojë, që aksionet e reja të marrin pjesë nga fitimet e vitit financiar paraardhës.

NENI 10

Zvogëlimi i Kapitalit

(1) Asambleja e Aksionarëve, nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë. Në çdo rast, zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të Shoqërisë duhet të miratohet nga Banka e Shqipërisë sipas parashikimeve të Ligjit për Bankat.

(2) Në rastet kur zvogëlimi i kapitalit nuk kryhet për shkak të humbjeve të aktivitetit tregtar, Asambleja e Aksionarëve, nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm, mund të vendosë të anulohet një a më shumë aksione në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar, e në veçanti të nenit 149 dhe 181 e në vijim të këtij ligji.

(3) Pas marrjes së miratimit të zvogëlimin nga Banka e Shqipërisë, Shoqëria regjistron e publikon zvogëlimin e kapitalit pa vonesa pranë QKB-së.

NENI 11

Kalimi i Aksioneve

(1) Aksionet e Shoqërisë mund të transferohen lirisht sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar, Ligjit për Bankat dhe këtij Statuti. Aksionet e Shoqërisë mund të transferohen lirisht ndërmjet Aksionarëve dhe/ose shoqërive të kontrolluara nga ata.

(2) Transferimi *inter vivos* i aksioneve tek Personat e tretë do t'i nënshtrohet të drejtës së parablerjes nga Aksionarët e tjerë në përputhje me nenin 11(5) të këtij Statuti.

(3) Pa cënuar parashikimet e mësipërme, në rast se transferimi i aksioneve do të shkaktonte ndryshim të Pjesëmarrjes Influencuese në kapitalin e Shoqërisë, transferimi do të miratohet nga Asambleja e Aksionarëve dhe do t'i parashtrohet për miratim Bankës së Shqipërisë në përputhje me dispozitave të Ligjit për Bankat.

(4) Shoqëria do t'i njoftojë Bankës së Shqipërisë çdo ndryshim tjetër në strukturën e kapitalit të saj në përputhje me dispozitat e Ligjit për Bankat dhe regulloreve në fuqi.

(5) Në rast se një aksionar i Shoqërisë ("**Aksionari Transferues**") ka për qëllim t'i transferojë një pjesë apo të gjitha aksionet e tij ("**Aksionet e Ofruara**") shoqërive të tij të kontrolluara, një Aksionari tjetër apo një Personi të tretë, ai do t'i dërgojë Aksionarëve të tjerë një njoftim me shkrim ("**Njoftimi i Transferimit**"), i cili duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Numrin e Aksioneve të Ofruara;
- Emrin e Shoqërisë së Kontrolluar, Personit të Tretë ose Aksionarit tjetër;
- Çmimin e Aksioneve të Ofruara ose një shënim që transferimi kryhet pa pagesë;
- Afatet e pagesës, dhe
- Çdo kusht tjetër që i zbatohet transferimit.

(6) Një kopje e Njoftimit të Transferimit duhet t'i njoftohet edhe Këshillit Mbikqyrës.

(7) Në rast se sipas Njoftimit të Transferimit Aksionet e Ofruara do t'i ofrohen një Personi të tretë, i cili nuk është Aksionar apo Shoqëri e Kontrolluar nga Aksionari Transferues, atëherë secili apo të gjithë Aksionarët e tjerë të Shoqërisë të cilët pranojnë pa kushte të blejnë Aksionet e Ofruara, në përputhje me parashikimet e këtij neni dhe ato të Njoftimit të Transferimit, kanë të drejtë të blejnë Aksionet e Ofruara dhe të preferohen ndaj Personave të tretë ("**E Drejta e Parablerjes**"). Kushtet e tjera të kontratës së transferimit të aksioneve janë ato që përcaktohen nga Njoftimi i Transferimit. Ushtrimi i së Drejtës së Parablerjes për një pjesë të Aksioneve të Ofruara nuk është i mundur.

(8) Në rast se pas marrjes së Njoftimit të Transferimit një apo më shumë Aksionarë të tjerë dëshirojnë të blejnë Aksionet e Ofruara dhe të drejtat që rrjedhin nga to, atëherë këta Aksionarë ("**Aksionarët që Ushtrijnë të Drejtën e Parablerjes**") duhet të njoftojnë me shkrim Aksionarin Transferues jo më vonë se 30 (tridhjetë) Ditë Kalendarike nga marrja e Njoftimit të Transferimit ("**Afati i Pranimit**") mbi ushtrimin e së Drejtës së Parablerjes duke pranuar të blejnë pa kushte të gjitha Aksionet e Ofruara sipas kushteve të Njoftimit të Transferimit ("**Njoftimi i Pranimit**"). Një kopje e Njoftimit të Pranimit duhet t'i njoftohet edhe Këshillit Mbikqyrës. Mos dërgimi i Njoftimit të

Pranimi brenda Afatit të Pranimit nga ana e Aksionarëve do të konsiderohet si heqje dorë nga e Drejta e tyre e Parablerjes.

(9) Në rast se ka më shumë se një Aksionarë që Ushtrjnë të Drejtën e Parablerjes, atëherë e Drejta e Parablerjes mbi Aksionet e Ofruara do të ushtrohet nga këta Aksionarë në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë (“**Transferim Proporcional**”).

(10) Aksionari Transferues dhe Aksionari/ët që Ushtrjnë të Drejtën e Parablerjes do të nënshkruajnë një kontratë transferimi aksionesh për Aksionet e Ofruara (“**Kontrata**”) sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 30 (tridhjetë) Ditë Kalendarike pas marrjes së Njoftimit të Pranimit nga Aksionari Transferues. Në rast Transferimi Proporcional, afatet e mësipërme do të llogariten në mënyrë të pavarur për çdo Aksionar që Ushtron të Drejtën e Parablerjes.

(11) Mos nënshkrimi apo refuzimi i Aksionarit që Ushtron të Drejtën e Parablerjes për të nënshkruar Kontratën brenda afatit të mësipërm dhe në përputhje me kushtet e Njoftimit të Transferimit, përveç se kur mos nënshkrimi apo refuzimi për të nënshkruar ka ardhur si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të Aksionarit Transferues, do të konsiderohet si heqje dorë nga e Drejta e Parablerjes dhe Aksionari Transferues do të jetë i lirë të transferojë Aksionet e Ofruara tek Persona të tretë sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në Njoftimin e Transferimit. Në rast Transferimi Proporcional, mos nënshkrimi apo refuzimi i njërit prej Aksionarëve që Ushtrjnë të Drejtën e Parablerjes për të nënshkruar Kontratën nuk do të ndikojë të drejtat e Aksionarëve të tjerë që ushtrojnë të Drejtën e Parablerjes, të cilët pa formalitete të mëtejshme dhe në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë, në mënyrë automatike (pa përsëritur procedurën) do të marrin të drejtat e Aksionarit që nuk ka nënshkruar apo ka refuzuar të nënshkruajë Kontratën.

(12) Procedura e parashikuar në këtë nen duhet të përsëritet në rast se pas përfundimit të Afatit të Pranimit, ose sipas rastit pas mos nënshkrimit apo refuzimit të nënshkrimit të Aktit për transferimin e Aksioneve të Ofruara, Aksionet e Ofruara do t'i transferohen Palëve të Treta sipas kushteve thelbësisht të ndryshme nga ato që janë njoftuar në Njoftimin e Transferimit.

(13) Çdo transferim aksionesh i kryer në kundërshtim me parashikimet e këtij neni do të jetë i pavlefshëm dhe do të përbëjë një shkelje të detyrimit të besnikërisë nga Aksionari përgjegjës i cili do të mbajë përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin Tregtar.

(14) Në rast vdekjeje apo likuidimi/falimentimi të një Aksionari, aksionet e zotëruara nga ai do t'i transferohen Trashëgimtarëve të tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 12

Regjistri i Aksioneve

(1) Këshilli Mbikqyrës harton një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat përcaktuara sipas Ligjit Tregtar në lidhje me të gjitha aksionet e Shoqërisë. Këshilli Mbikqyrës, sipas rastit, hedh të dhënat e aksioneve të emetuara rishitazi sipas Akteve të Emetimit të Aksioneve apo regjistron anulimin e aksioneve. Këshilli Mbikqyrës regjistron gjithashtu në këtë regjistër kalimin aksionesh që i njoftohet nga Aksionari që e kalon aksionin, si dhe çdo veprim të dhënë tjetër në lidhje me aksionet që mund të kërkohet me ligj apo sipas vendimeve të Shoqërisë.

(2) Personat e regjistruar në regjistrin e aksioneve prezumohen Aksionarë të Shoqërisë me të drejta të plota si për marrëdhëniet me Shoqërisë, ashtu dhe ndaj të tretëve. Aksionet e të drejtat e fituara mbi to, nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj Shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin aksionesh që mban Shoqëria.

(3) Këshilli Mbikqyrës njofton, herë pas here, dhe brenda afateve të kërkuara, të dhënat e regjistrimit të aksioneve të Shoqërisë sipas kërkesave ligjore, dhe veçanërisht listën e aksionarëve pranë QKB-së në përputhje me Ligjin për QKB-në dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Titujt (në rastet kur ky regjistrim kërkohet nga ligji).

(4) Çdo Aksionar mund t'i kërkojë Shoqërisë lëshimin e një vërtetimi mbi të dhënat e tij të regjistrimit në regjistrin e aksioneve të Shoqërisë. Në bazë të vendimit të Asamblesë së Aksionarëve, Shoqërsia mund të lëshojë certifikata për vërtetimin e zotërimit të aksionit.

(5) Asambleja e Aksionarëve miraton, ose i delegon Këshilli Mbikqyrës kompetencën për të miratuar rregullore të posaçme mbi formatin e regjistrimit të aksioneve si dhe mbi procedurat për kryerjen e regjistrimeve.

(6) Këshilli Mbikqyrës kujdeset që këto aksione të regjistrohen edhe në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve (QRA) dhe të përditësohet për çdo ndryshim sipas dispozitave të Ligjit për Titujt, Ligjit Tregtar dhe akteve nënligjore në fuqi.

TITULLI IV Asambleja e Përgjithshme

NENI 13

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

(1) Asambleja e Aksionarëve thirret në përputhje me nenin 136, 137, 138 dhe 139 të Ligjit Tregtar nga Këshilli Mbikqyrës, e në rast urgjence nga çdo anëtar Këshilli apo çdo Drejtor Ekzekutiv, sa herë që e konsiderojnë të arsyeshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë apo sa herë që thirrja e Asamblesë së Aksionarëve është e detyrueshme sipas Ligjit Tregtar ose dispozitave të tjera ligjore. Asambleja e Aksionarëve mund të thirret edhe nga personat e tjerë të përcaktuar sipas Ligjit Tregtar. Asambleja e Aksionarëve duhet të thirret të paktën një herë gjatë një viti financiar për miratimin e bilancit vjetor.

(2) Asambleja e Aksionarëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë apo me mjete elektronike, në përputhje me legjislacionin për nënshkrimin elektronik, drejtuar çdo Aksionari. Thirrja e Asamblesë së Aksionarëve duhet të njoftohet të paktën 21 (njëzetë e një) ditë kalendarike përpara datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat dhe informacionin e përcaktuar në nenin 137 të Ligjit Tregtar. Në rast se mbledhja mbahet me mjete komunikimi, të ndryshme nga prania e njëkohshme e pjesëmarrësve në një vendndodhje të caktuar, përfshi këtu komunikimin me mjete elektronike, Aksionarëve u njoftohen gjithashtu mënyrat e komunikimit dhe të vërtetimit të identitetit dhe të nënshkrimeve (në rastet e komunikimeve elektronike, sipas legjislacionit përkatës për nënshkrimin elektronik).

(3) Aksionarët nuk mund të kërkojnë shpalljen e pavlefshmërisë së mbledhjes së Asamblesë për shkak të mungesës së njoftimit, nëse Aksionari i ka dhënë Shoqërisë një adresë të pasaktë (përfshi adresën elektronike) për regjistrim pranë Regjistrat të Aksioneve, apo nuk i ka njoftuar Këshillin Mbikqyrës ndryshimin e adresës (përfshi adresën elektronike) përpara dërgimit të njoftimit.

(4) Asambleja e Aksionarëve merr vendime për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore;
 - b) shpërndarja e fitimeve vjetore të vitit financiar të mëparshëm;
 - c) emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) ndryshime në statutin e Shoqërisë;
 - e) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - f) lëshimi dhe konvertimi i Letrave Me Vlerë/Titujve të Shoqërisë;
 - g) miratimin e skemës së shpërblimeve të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, Drejtorët Ekzekutiv, Administratorët dhe ekspertët kontabël;
 - gj) miratimin për vazhdimin e aktiviteteve të shoqërisë ose zgjerimin e tyre si dhe për ri-organizimin e Shoqërisë;
 - h) parimet bazë, kriteret për përcaktimin skemës së shpërblimeve të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës dhe Drejtorëve Ekzekutiv;
 - i) transferim, ndarjen, pengun/barrësimin e aksioneve të Shoqërisë
- Panëvarësisht nga sa më lartë, Asambleja e Aksionarëve merr vendime për çështjet të parashikuara në Lgjin Tregtar.

NENI 14

Punimet e Mbledhjes së Asamblesë së Aksionarëve

(1) Asambleja e Aksionarëve nuk mund të kryejë punime e të marrë asnjë vendim nëse nuk është plotësuar kuorumi i parashikuar në Nenin 144 të Ligjit Tregtar. Aksionarët mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet caktimit të përfaqësuesve, nëpërmjet *teleconferencës*, audio ose video, si dhe të mjeteve të tjera elektronike në përputhje me Nenin 142 të Ligjit Tregtar (**Aksionarët e Pranishëm**). Aksionarët që marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike mund të votojnë në mbledhje në mënyrë elektronike, pas verifikimit të identitetit të tyre në mënyrë elektronike sipas kërkesave të legjislacionit për nënshkrimin elektronik, të përcaktuar në njoftimin e thirrjes së Asamblesë.

(2) Kryetari i Këshillit Mbikqyrës do të kryesojë Asamblenë e Aksionarëve dhe do të caktojë një person si mbajtës të procesverbalit. Aksionarët e pranishëm me të drejtë vote, me shumicën e $\frac{1}{4}$ të votave të zotëruara prej tyre, mund të vendosin që mbledhja të kryesohet nga një person tjetër.

(3) Nëse Kryetari i Këshillit Mbikqyrës nuk është i pranishëm apo nuk dëshiron të veprojë si Kryetar i Asamblesë, Aksionarët e Pranishëm me të drejtë vote, me shumicën e $\frac{1}{2}$ të votave të zotëruara prej tyre, do të caktojnë Kryetarin dhe personin që do të mbajë procesverbalin e mbledhjes.

(4) Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës dhe Drejtori/ët Ekzekutivë kanë të drejtë të marrin pjesë në çdo kohë në mbledhjet e Asamblesë së Aksionarëve.

(5) Kryetari, përpara nisjes së punimeve të mbledhjes së Asamblesë së Aksionarëve, verifikon numrin e Aksionarëve të pranishëm personalisht, me mjete elektronike apo nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, si dhe identitetin e numrin e votave të zotëruara nga secili prej tyre, plotësimin e kuorumit për mbajtjen e Asamblesë dhe kuorumin e nevojshëm për marrjen e vendimeve sipas rendit të ditës. Lista e pjesëmarrësve përmban të dhënat e mësipërme dhe nënshkruhet nga secili pjesëmarrës.

NENI 15

Votat e Aksionarëve

(1) Në varësi të të drejtave ose kufizimeve që lidhen me aksionet, secili aksion i zakonshëm mbart të drejtën e 1 (një) vote në mbledhjen e Asamblesë së Aksionarëve. Aksionari mund të përjashtohet nga e Drejta e Votës sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar dhe të këtij Statuti. Aksionarët votojnë në mënyrë uniforme për të gjitha aksionet e zotëruara prej tyre.

(2) Vendimet e Asamblesë merren sipas shumicës përkatëse të votave përcaktuar në këtë Statut dhe në nenin 145 të Ligjit Tregtar.

(3) Vendimet e Asamblesë miratohen me votim të hapur nëse përpara deklarimit të rezultati nuk është kërkuar një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohej nga Kryetari ose nga Aksionarët e Pranishëm që zotërojnë jo më pak se 5% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

(4) Nëse nuk kundërshtohet nga ndonjë Aksionar, deklarimi i Kryetarit në lidhje me miratimin apo mosmiratimin e një vendimi nga Asambleja e Aksionarëve, si dhe shumica me të cilën është votuar regjistrohet në procesverbalin e mbledhjes dhe konsiderohet vendim i formës së prerë, pa qenë e nevojshme prova për numrin apo përqindjen e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit. Nëse ka kundërshtime, ky fakt shënohet në procesverbal, dhe Kryetari numëron votat pro ose kundër, dhe nëse ka paqartësi, Asambleja voton çështjen për herë të dytë.

(5) Mënyrat e votimit të fshehtë përcaktohen në rregulloren e punimeve të Asamblesë së Aksionarëve. Në rastin e votimit me mjete elektronike, mënyra e votimit duhet të garantojë fshehtësinë e votës.

(6) Të gjitha vendimet e Asamblesë së Aksionarëve regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes. Procesverbali përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, mënyrën e mbajtjes së mbledhjes dhe të votimit, rezultatet e votimit, regjistrimin në lidhje me diskutimet e mbledhjes dhe çështjet e tjera që duhet të shënohen në të sipas Ligjit Tregtar apo rregullores së punimeve të Asamblesë së Aksionarëve.

(7) Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, autorizimet për votim (nëse ka), si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. Në rastin kur mbledhja zhvillohet me mjete elektronike, procesverbalit i bashkëngjiten kopjet e printuara të dokumenteve elektronike që vërtetojnë pjesëmarrjen dhe nënshkrimin elektronik. Procesverbali i mbledhjes, lista e pjesëmarrësve e dokumentet e tjera të bashkëlidhura, nënshkruhen nga Kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

(8) Këshilli Mbikqyrës përgjigjet për ruajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Aksionarëve. Kur procesverbali përmban të dhëna konfidenciale për aktivitetin e Shoqërisë, Këshilli Drejtues mund të nxjerrë vetëm ekstrakte të këtij procesverbali.

(9) Këshilli Mbikqyrës, jo më vonë se 15 ditë nga mbledhja i njofton Aksionarëve apo përfaqësuesve të tyre kopje të procesverbalit, dhe, nëse është vendosur nga Asambleja, e publikon atë në një seksion të veçantë të website-it të aksesueshëm vetëm nga Aksionarët.

(10) Nëse mbledhja mbahet nëpërmjet komunikimeve elektronike, ajo konsiderohet e mbajtur në orën dhe vendin e selisë së Shoqërisë.

NENI 16

Përfaqësimi në Asamble

(1) Një Aksionar mund të autorizojë persona të tjerë sipas dispozitave të Ligjit Tregtar për ta përfaqësuar atë në mbledhjet e Asamblesë së Aksionarëve. Një aksionar nuk mund të autorizojë persona të ndryshëm që ta përfaqësojnë në lidhje me pjesë të ndryshme të aksioneve të tij.

(2) Autorizimi mund të jepet me mjete elektronike, me kusht që nënshkrimi të vërtetohet në përputhje me legjislacionin mbi nënshkrimin elektronik dhe autorizimi të dërgohet, jo më vonë se 24 orë përpara orës së datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, nëpërmjet një mesazhi elektronik në adresën e postës elektronike të Shoqërisë që i është njoftuar Aksionarëve.

TITULLI V
Administrimi i Shoqwrsw

NENI 17

Këshilli Mbikqyrës

Emërimi, Shkarkimi, Vendet e lira, Kompetencat, Shpërblimi

- (1) Shoqëria do të administrohet nga Këshilli Mbikqyrës i përbërë nga një numër tek anëtarësh, nga 3 (tre) deri në 21 (njëzetë e një) anëtarë, sipas vendimit të Asamblesë së Aksionarëve.
- (2) Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës emërohen nga Asambleja e Aksionarëve nëpërmjet një vendimi të zakonshëm, për një periudhë 3-vjeçare dhe kanë të drejtë të rizgjidhen për të njëjtin mandat, pa kufizim. Këshilli Mbikqyrës me shumicë votash të të gjithë anëtarëve emëron ndërmjet anëtarëve të tij Kryetarin dhe Zv. Kryetarin të cilët do të kryesojnë mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës. Emërimi ka pasoja ligjore pas regjistrimit në QKB. Asambleja e Aksionarëve mund të vendosë rregulla në lidhje me emërimin e tyre.
- (3) Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk duhet të kryejnë funksione administrimi dhe shumica e tyre duhet të jenë të pavarur.
- (4) Asambleja e Aksionarëve mund të shkarkojë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës në çdo kohë me anë të një Vendimi të Zakonshëm.
- (5) Këshilli Mbikqyrës është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave të shoqërisë dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë. Në veçanti, Këshilli Mbikqyrës ka detyrat dhe të drejtat e parashikuara në nenin 167 të Ligjit Tregtar.
- (6) Mënyra e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të përcaktohet nga Asambleja e Aksionarëve.

NENI 18

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës

- (1) Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës do të realizohen sa herë të konsiderohet e nevojshme nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës apo të kërkohet nga të paktën dy anëtarë të Këshillit.
- (2) Njoftimi për mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës duhet të përcaktojë kohën, ditën dhe adresën ku do të mbledhet Këshilli dhe duhet t'i dërgohet të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, me postë apo me mjete elektronike në përputhje me legjislacionin për nënshkrimin elektronik të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen. Çdo veprim që duhet apo lejohet të merret nga Këshilli Mbikqyrës mund të merret edhe pa qenë nevoja të mbledhet Këshilli në rast se vendimi që autorizon këtë veprim nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës.
- (3) Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës mund të ndjekin mbledhjet e Këshillit me anë të përfaqësuesve të autorizuar, *teleconferences* audio apo vizuale dhe mjeteve të tjera elektronike.
- (4) Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës konsiderohen të mbledhura rregullisht me pjesëmarrjen e shumicës së anëtarëve. Vendimet e Këshillit Mbikqyrës merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast barazimi votash, vota e Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës do të jetë vendimmarrëse.

NENI 19

Drejtorët Ekzekutivë

Emërimi, Kompetencat, Shpërblimi

- (1) Këshilli Mbikqyrës emëron një ose më shumë persona fizikë si Drejtor(ë) Ekzekutiv(ë) të Shoqërisë. Drejtor(ët) Ekzekutiv(ë) emërohen sipas afatit të vendosur nga Këshilli Mbikqyrës në aktin e emërimit. Në rast heshtje, emërimi konsiderohet i bërë për një afat prej 3 vitesh. Drejtor(ët) Ekzekutiv(ë) mund të rrimërohen. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk mund të emërohen si Drejtor(ë) Ekzekutiv(ë). Emërimi ka pasoja ligjore pas miratimit nga Këshilli Mbikqyrës dhe regjistrimit në QKB.
- (2) Drejtorit/ët Ekzekutiv(ë) janë përfaqësuesit ligjor të Shoqërisë, dhe kanë të drejtë të përfaqësojnë Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët. Këshilli Mbikqyrës mund të vendosë kufizime në lidhje me tagrat e përfaqësimit të Drejtorit/ëve Ekzekutiv(ë) për kryerjen e veprimeve të caktuara tregtare dhe/ose veprimeve me vlerë të caktuar, veçanërisht duke parashikuar miratime paraprake nga Këshilli dhe/ose nënshkrimin e dyfishtë me një anëtar tjetër të Këshillit Mbikqyrës.
- (3) Tagrat e përfaqësimit të Drejtorit/ëve Ekzekutiv(ë) dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen pranë QKB-së në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar. Drejtorit/ët Ekzekutiv(ë), të cilët kanë të drejtë ta përfaqësojnë Shoqërinë në mënyrë të përbashkët, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.

- (4) Këshilli Mbikqyrës mund të shkarkojë Drejtorin/ët Ekzekutiv(ë) në çdo kohë.
- (5) Mënyra e shpërbimit të anëtarëve të Drejtorit/ëve Ekzekutiv(ë) do të përcaktohet nga Këshilli Mbikqyrës.
- (6) Drejtori/ët Ekzekutiv(ë) duhet të marrin miratimin e Këshillit Mbikqyrës për çështje të cilat konsiderohen të një rëndësie të vecantë. Çështjet si më poshtë do konsiderohen të një rëndësie të vecantë:
- a) kryerjen e një transaksioni në emër të Shoqërisë, nëse vlera e një ose më shumë transaksioneve të të njëjtës natyre (brenda një viti financiar) në gjendjen financiare të kompanisë, e tejkalon 100,000 EUR (njëqind mijë euro) ose shumën ekuivalente në Lekë (Lekë) dhe transaksioni (et) është (janë), jashtë aktivitetit ditë-për-ditë të Shoqërisë;
- b) Shitja ose çdo lloj tjetër të tjetërsimit të asetëve të Shoqërisë, si vendosja e barrës/pengjuit mbi asetet e Shoqërisë në një mënyrë që së bashku, tejkalojnë 100.000 euro (njëqind mijë euro) ose shuma ekuivalente në Lekë (Lekë) brenda një viti financiar, dhe kjo kur është jashtë aktivitetit ditë-për-ditë të Shoqërisë;
- c) Asgjësimin ose transferimin e të drejtës së shfrytëzimit, pronësisë intelektuale në pronësi të Shoqërisë, duke përfshirë patentat, shpikjet, software, know-how, marka (fjala / të kombinuar), ose internet domain tek një palë e tretë për tu paguar ose pa kompensim, përveçse ato të lidhura me aktivitetin ditë-për-ditë të Shoqërisë;
- d) Punësimi i punonjësve paga totale neto e të cilëve i kalon 100,000 EUR (njëqind mijë euro) ose shumën ekuivalente në Lekë (Lekë) në vit, çdo ndryshim në kushtet e punësimit të këtyre punonjësve dhe shkarkimin e tyre;
- e) Çdo veprimtari tjetër që ndryshon nga aktiviteti ditë-për-ditë të Shoqërisë, nëse vlera ose ndikimi i aktivitetit të tillë (brenda një viti financiar) në gjendjen financiare të Shoqërisë e tejkalon 50,000 euro (pesëdhjetë mijë euro) ose shumën ekuivalente në Lekë (Lekë).

TITULLI VI

Dividendët dhe Rezervat

NENI 20

Dividendët

- (1) Me miratimin e pasqyrave financiare të vitit të mëparshëm financiar, nga fitimi i realizuar Shoqëria nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm të Asamblesë së Aksionarëve mund të shpërndajë dividend në favor të Aksionarëve, në përputhje me përqindjen e kapitalit që përfaqësojnë Aksionet e zotëruara prej tyre si dhe në përputhje me legjislacionin bankar.
- (2) Dividendi paguhet në një ose disa këste, duke pasur parasysh nevojat e likuiditetit të Shoqërisë.

NENI 21

Rezervat

Asambleja e Aksionarëve krijon rezerva sipas përcaktimeve të Ligjit për Bankat, dhe me propozim të Këshillit Mbikqyrës, mund të krijojë rezerva të posaçme nga fitimet e aktivitetit të Shoqërisë për mbarëvajtjen e aktivitetit të saj.

TITULLI VII

Neni 22

Rregulloret, Komitetet dhe Marrëveshjet midis Aksionarëve

- (1) Asambleja e Aksionarëve me shumicë të Jashtëzakonshme mund të miratojë rregullore me efekte detyruese, në lidhje me thirrjen, zhvillimin dhe vendimmarrjen në mbledhjet e Asamblesë, përfshi këtu procedurat për llogaritjen e kuorumit e të numërimit të votave, si dhe për çdo çështje tjetër që konsideron të nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë.
- (2) Këshilli Mbikqyrës mund të miratojë rregullore me efekte detyruese, në lidhje me thirrjen, zhvillimin dhe vendimmarrjen në mbledhjet e Asamblesë, përfshi këtu procedurat për llogaritjen e kuorumit e të numërimit të votave, si dhe për çdo çështje tjetër që konsideron të nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë. Vendimi i Këshillit Mbikqyrës për miratimin e kësaj rregulloreje duhet të merret me unanimitet. Në rast se unanimiteti nuk arrihet, rregullorja miratohet nga Asambleja e Aksionarëve me shumicë të zakonshme.
- (3) Aksionarët mund të lidhin mes tyre marrëveshje për ushtrimin e të drejtës së votës, ndarjen e dividendëve, kalimin e aksioneve apo marrëveshje të tjera që lidhen me ushtrimin e të drejtave e detyrimeve të Aksionarëve në lidhje me Shoqërinë. Shkelja e këtyre marrëveshjeve midis aksionarëve do të përbejë një shkelje të detyrimit të besnikërisë sipas Ligjit Tregtar, duke e detyruar

**STATUTE OF
THE
JOINT STOCK COMPANY
MOGO ALBANIA SH.A**

INDEX

TITLE I.....	5
Incorporation, Name, Purpose, Duration, Registered Office and Website.....	5
ARTICLE 1	5
Incorporation.....	5
ARTICLE 2	5
Purpose of the Company.....	5
ARTICLE 3	5
Duration.....	5
ARTICLE 4	5
Registered Office, Website and electronic address, Intellectual Property	5
TITLE II	5
Registered Capital, Contributions, Shares, Shareholders.....	5
ARTICLE 5	5
Registered Capital, Contributions.....	5
ARTICLE 6	5
Shares, Shareholders.....	5
TITLE III	6
Changes to the capital, changes to the Shares, the Share Registry.....	6
ARTICLE 7	6
Increase of the Share Capital.....	6
ARTICLE 8	6
Publication of the Increase, Realization of the Increase	6
ARTICLE 9	6
Share Emission Act	6
ARTICLE 10	7
Reduction of the Capital.....	7
ARTICLE 11	7
Transfer of Shares.....	7
Article 12.....	8
The Share Registry	8
TITLE IV	8
The General Meeting	8
ARTICLE 13	8
Convening General Meetings.....	8
ARTICLE 14	9
Proceedings of the General Meeting.....	9
ARTICLE 15	10
Votes of Shareholders.....	10
ARTICLE 16	10
Voting by Proxy	10
TITLE V	10
Management of the Comapny.....	10
ARTICLE 17	10
Supervisory Board.....	Error! Bookmark not defined.
Appointment, Dismissal of Directors, Vacancies, Powers, Remuneration.....	10
ARTICLE 18	11
Meetings of the Supervisory Board	11
ARTICLE 19	11
Managing Directors	11
Appointment, Powers, Remuneration	11
TITLE VI.....	12
Dividends and Reserves.....	12
ARTICLE 20	12
Dividends.....	12
ARTICLE 21	12

Reserves	12
TITLE VII.....	12
Article 22.....	12
By - Laws, Committees, Shareholder's Agreements.....	12
TITLE VIII	13
Dissolution and Liquidation	13
ARTICLE 23	13
Dissolution and Liquidation	13
TITLE IX	Error! Bookmark not defined.
Final Provisions	
ARTICLE 24	
Company Bodes	
ARTICLE 25	
Miscellaneous	

**STATUTE OF
THE JOINT STOCK COMPANY**

MOGO ALBANIA SH.A

Whenever used in this document, unless otherwise specified, the following terms shall mean:

"Company Law":	Law no. 9901 date 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies";
"Banking Law":	Law no. 9662 date 18.12.2006 "On Banks in the Republic of Albania"; Law No. 8269 date 23.12.1997 "On the Bank of Albania" and Regulation No.01, date 17.01.2013 amended "On Licensing And Activity Of Non-Bank Financial Institutions" or any amendment that the law may have;
"Statute":	This statute of the joint stock company Mogo Albania Sh.a
"Company":	Mogo Albania Sh.a. established as a joint stock company (Sh.a.) under the Albanian law and subject to license as non-bank financial institutions from the Bank of Albania;
"Shareholder(s)":	As the case may be, individuals or legal entities holding shares of the Company as provided by art. 5, 6 and 11 of this Statute;
"Ordinary Resolution":	The resolution passed by the General Meeting by the majority of votes of participating shareholders as provided by article 145 (2) of the Company Law;
